




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCY AGAINST CORRUPTION	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-4337/13
Dep. 02	Prot. No. 17-12-2013
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-3049\13, për zyrtarin e lartë z. Refki Bytyqi, nënkryetar i Komunës e Suharekës (Therandës), për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3049/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin i Lartë, z. Refki Bytyqi, nënkryetar i Komunës e Suharekës (Therandës).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si nënkryetar i Komunës së Suharekës, është duke ushtruar edhe një funksion në biznesin e tij privat "N.SH.T. Medikos", e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 16.10.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Refki Bytyqi, nënkryetar i Komunës e Suharekës (Therandës), pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë, përmes përfaqësuesit ligjor të tij, ka kërkuar që ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, po ashtu zyrtari në fjalë pasi që ka marrë edhe informatat në mënyrë verbale, është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet dhe është zotuar se do të fillojë menjëherë procedurat për autorizimin e një personi që ta administroi biznesin e tij gjatë kohës sa ushtron funksion publik.

Zyrtari i lartë, z. Refki Bytyqi, nënkryetar i Komunës së Suharekës (Therandës), pas kësaj ka sjellë dëshmitë nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka autorizuar një person për ta udhëhequr biznesin “N.SH.T. Medikos”,

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Refki Bytyqi, nënkryetar i Komunës së Suharekës (Therandës), pasi ka bërë ndryshimet në biznesin e tij “N.SH.T. Medikos”, dhe nuk ushtron me pozitë menaxheriale në këtë biznes, dëshmohet se ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

